



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0030667/22 datë 29.04.2022 për kushtet kriteret dhe proceduat e ndarjes së subvencioneve, neneve 14 dhe 19 paragrafi 1.11 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, në kërkesë me nr.prot.164/22 të datës 14.09.2022 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 09 dhjetor 2022, mori këtë:

VENDIM

PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevës sipas cilës Komuna e Podujevës, për qytetarët me vendbanim të përherëshëm përkatësisht personat që vdesin dhe varrosen në territorin e saj, bënë subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për periudhën deri më 31.12.2024.

Neni 2

1. Për çdo të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja, bëhet subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit nga Bashkësia Islame përkatësisht Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë, që përfshijnë: transportin e kufomës, fletëljajmrimet (afishet), dërrasat, piramidën, pastrimin e kufomës, mbulesën e kufomës dhe qefinin.

2. Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë kërkesës për kompensim të shërbimeve përkatëse sipas çmimore, i bashkëngjit edhe konstatimin e vdekjes nga mjeku, dhe raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar – nënshkruar edhe nga ndonjëri prej familjarëve të ngushtë të të vdekurit (kopja ose numri i letërnjoftimi).

Neni 3

Autorizohet Kryetari i Komunës, të lidhë Marrëveshje Mirëkuptimi me Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, në cilësinë e subjektit të vetëm për ofrimin e shërbimeve sipas këtij vendimi, përmes së cilës definohej më në detaje obligimet dhe përgjegjësitë.

Neni 4

Subvencionimi bëhet nga mjetet buxhetore përkatësisht të hyrat vetanake – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është çmimorja e shërbimeve.

Neni 6

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Administratës si dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021.

Nr.Prot. 01-400/03-0101080/22
Podujevë, datë; 09 dhjetor 2022

